



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



17/12/2010

**AUTORITETI
RREGULLATIV I
HEKURUDHAVE**

RAPORTI VJETOR I ARH –së 2010

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Struktura organizative e ARH -së	Error! Bookmark not defined.
Menaxhmenti / Administrata	Error! Bookmark not defined.

Hyrje

Fushëveprimi

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave është themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-076

Ky ligj zbatohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Kjo rregullon licencimin, certifikimin dhe lëshimin e lejeve që kanë të bëjnë me veprimtaritë hekurudhore në Kosovë.


Përgjegjësitë dhe funksionet e ARH

Autoriteti do të rregullojë sektorin e hekurudhave në Kosovë duke marrë parasysh urdhëresat evropiane mbi hekurudhat të cilat janë të përshtatshme për Kosovën.

Në pajtim me Ligjin, ARH-ja do të:

- nxjerrë, revokojë dhe mbikëqyrë përputhshmërinë me licencat, certifikatat e sigurisë dhe lejet
- nxjerrë rregulla dhe formularët e përshkruar lidhur me paraqitjen e kërkesë dhe kushtet për licenca, certifikata të sigurisë dhe leje
- miratojë pajisjet hekurudhore lidhur me sigurinë dhe Interoperabilitetit
- nxjerrë rregulla për sigurinë dhe Interoperabilitetit e sistemit të hekurudhave dhe do të mbikëqyrë pajtueshmërinë me këto rregulla
- kryejë dhe raportojë mbi inspeksionet e sigurisë
- shqyrtojë dhe vendosë mbi ankesat e bëra nga operatori hekurudhor lidhur me një vendim të menaxherit të infrastrukturës dhe do të nxjerrë procedura për ankesat e tilla
- zbatojë dhe raportojë hetimet e fatkeqësive dhe do të nxjerrë procedura përmes të cilave do të zbatohen hetimet e fatkeqësive;
- mbikëqyrë dhe do t'i ofrojë informacione Kuvendit dhe Ministrisë së Transportit dhe Postëtelekomunikacionit lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, çështjeve të ngjashme mbi sigurinë dhe kushtet e tregut për hekurudhat në Kosovë, me synim të paraqitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve hekurudhorë dhe
- bëjë rekomandime drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, duke përfshirë edhe legjislacionin për të promovuar konkurrencë të drejtë dhe jodiskriminuese dhe t'i sigurojë Kuvendit e Ministrisë të gjitha informacionet relevante dhe të nevojshme për vlerësimin e rekomandimeve të tilla.

Struktura Organizative e ARH-së



Menaxhmenti / Administrata

Personeli:

Rekrutimi i stafit të ARH-së

Konkursi për Pozitën Drejtor i Përgjithshëm dhe Asistente Administrative

Është shpallur me datën 25.05.2010 dhe është mbyllur 09.06.2010

Komisioni intervistues në përbërje:

Halit Gara – Kryetar i komisionit

Gëzim Qerimi – Aëntar i komisionit

Ilmi Ahmeti - Aëntar i komisionit

Lendita Osaj – Monitoruese e procesit nga MTPPT

Për pozitën Drejtor të Përgjithshëm kanë qenë të informuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikqyrës.

Intervista për Drejtor të Përgjithshëm është mbajtur me 25.06.2010 dhe është përzgjedhur kandidati më i sukseshmi Mr.sc. Enis Berisha dhe ka filluar punën me datë 15.07.2010.

Intervista për Asistente Administrative është mbajtur me 28.07.2010 dhe është përzgjedhur kandidatja më e sukseshme Mirjeta Ahmeti dhe ka filluar punën me datë 02.08.2010.

Konkursi për katër pozitat:

- 1.Kryesues i Departamentit të Administratës
- 2.Kryesues i Departamentit ligjor dhe i licencimit
- 3.Kryesues i Departamentit për çështjeve teknike, monitorim dhe hulumtim i aksidenteve dhe
- 4.Zyrtar i Financave

Konkursi është shpallur në datën 21.08.2010 dhe është mbyllur me datën 04.09.2010.

Vendimi i Kryesuesit të Bordit të ARH-së për formimin e Komisionit intervistues të datës 08.09.2010 për pozitën Zyrtar i Financave është caktuar me përbërje:

Gëzim Qerimi- Kryetar i komisionit

Ilmi Ahmeti- Anëtar i komisionit

Enis Berisha-Anëtar i komisionit

Lista e ngushtë është mbajtur në datën 15.09.2010 kurse intervista është mbajtur në datën 17.09.2010 dhe është përzgjedhur kandidati më i sukseshëm Shkelzen Qorri për pozitën Zyrtar i Financave duke filluar punën prej 01.10.2010.

Për pozitat:

- 1.Kryesues i Departamentit të Administratës
- 2.Kryesues i Departamentit ligjor dhe i licencimit
- 3.Kryesues i Departamentit për çështjeve teknike, monitorim dhe hulumtim i aksidenteve.

Sipas rekomandimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për tri pozitat është kërkuar që Komisioni intervistues të jetë i formuar nga një Anëtare e gjinisë femrore gjithashtu të ketë nivel më të lartë në pozitë se pozita e kërkuar.

Vendimi i Kryesuesit të Bordit të ARH-së për emërimin e Komisionit intervistues i datës 27.09.2010 është caktuar me përbërje:

Ilmi Ahmeti, Anëtar i Bordit në ARH, Kryetar i Komisionit

Enis Berisha, Drejtor i Përgjithshëm në ARH, Anëtar

Zana Kotorri, Sekretare e Përhershme në MKK, Anëtare

Për zgjedhjen e kryesuesve të tri departamenteve:

- 1.Kryesues i Departamentit të Administratës
- 2.Kryesues i Departamentit ligjor dhe i licencimit
- 3.Kryesues i Departamentit për çështje teknike, monitorim dhe hulumtim i aksidenteve

Lista e ngushtë është mbajtur në datën 30.09.2010 kurse për intervistë u vendos të ftohen për datën 13.10.2010 në këtë datë është mbajtur intervista për tri pozitat.

Për pozitën Kryesues i Departamentit për Çështje teknike / Hulumtim të aksidenteve është zgjedhur kandidatja më e suksesshme Zyrafete Zejnullahu, kurse për dy pozitat tjera është kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikqyrës të rishpallet konkursi për arsyje të mosplotesimit të kushteve nga kandidatët.

Rishpallja e konkursit për dy pozitat:

- 1.Kryesues i Departamentit të Administratës dhe
- 2.Kryesues i departamentit Ligjor dhe licencim

U rishpall në datën 14.10.2010 dhe mbyllja e konkursit në datën 28.10.2010.

Vendimi i Kryesuesit të Bordit të ARH-së për emërimin e Komisionit intervistues i datës 05.11.2010 është caktuar me përbërje:

Komisioni intervistues i përbërë prej tre anëtareve:

Ilmi Ahmeti, Anëtar i Bordit në ARH, Kryetar i Komisionit

Enis Berisha, Drejtor i Përgjithshëm në ARH, Anëtar

Zana Kotorri, Sekretare e Përhershme në MKK, Anëtare

Lista e ngushtë u mbajtur me 08.11.2010 ku intervista u caktua të mbahet në datën 10.11.2010 Komisioni vendosi që kandidati i cili i plotësoi të gjitha kushtet për Kryesues të Departamentit të Administratës të zgjedhet Murtez Zekolli duke filluar punën prej datës 15.11.2010.

Për pozitën Kryesues i Departamentit Ligjor dhe Licencim sipas Këshillit të Pavarur Mbikqyrës u konstatua që për këtë pozitë edhe kesaj here asnjë kandidat nuk i plotësoi kushtet e kërkuara.

Financat:

Përmbledhje e përgjithshme

Sektori I Financave kryen punët dhe detyrat në bazë të **Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë** si obligim dhe përgjegjësi

Fushat në të cilën është I fokusuar ky sektor janë:

- Planifikimi i buxhetit të ARH-së
- Përgatitja e raporteve financiare
- Mbikqyrja e Zotimeve,shpenzimeve dhe certifikimeve te lendeve ne sistem te Free Balancit-it
- Përgatitja e raporteve standarde të të hyrave dhe shpenzimeve
- Nxjerrja e raporteve, analiza dhe shqyrtimi i bilanceve dhe shërbimeve te përgjegjësisë financiare
- Mbarëvajtja e procedurave dhe sistemeve adekuate financiare të BKK-së, përfshirë sistemin e pagesës së rrogave dhe shtesave të punëtorëve
- Mbajtja llogarisë së kontabilitetit në mënyrë te pavarur
- Krijimi sistemit funksional të raportimit financiar për mbikëqyrësin
- Mirëmbajtja e llogarive dhe faturave
- Koordinimi i shënimeve dhe menaxhimi i Arkës (Petty Cash-it) në bazë të Ligjit nr.03/L-048
- Koordinimi dhe përgatitja të gjitha llojet e raporteve të çmimeve dhe shpenzimeve
- Regjistrimi i të gjitha pagesave përmes një sistemi aktual të arkivimit

Sektori i Financave - gjatë periudhës 01.10-30.11/2010 është bazuar dhe mbështetur në Ligjin e lartë përmendur Nr 03//L-048 dhe është munduar që të bëj të gjitha përgaditjet e duhura që të funksionoj maksimalisht si sektor pasi që ne edhe si ARH tanimë ende jemi në fazën e konsolidimit në tërësi .

Prandaj përgaditjet e duhura teknike dhe organizative për ne si sektor i Financave dhe si ARH në përgjithësi janë një hap shumë i rëndësishëm për të filluar së mirëfunksionuari dhe së përgadituri për programin e punës së vitit në vijim për realizimin e punëve dhe detyrave me një efikasitet maksimal dhe në harmoni me ligjet dhe udhëzimet në fuqi .

Situata e personelit

Në kuadër të këtij sektori për periudhën raportuese është i punësuar 1 zyrtar financiar ku dhe sipas rregullave mbi sistematizimin e vendëve të punës dhe skemës organizative që është nxjerr nga ARH-ja nga ky sektor gjatë këtij viti është paraparë të jetë 1 zyrtar financiar si i vetëm

Struktura kualifikuese:

-Fakulteti ekonomik -----1

GJENDJA RAPORTUESE

Ne si Autoritet Rregullativ te themeluar gjatë vitit 2010 ende jemi ne fazen e konsolidimit ne pergjithesi andaj edhe ne si sektor I Financave jemi duke kryer punet dhe sherbimet financiare permes zyrtarëve Financiar te MTPT-së ne bazë te nje marreveshje bashkepunimi ne mes ARH-së dhe MTPT deri ne certifikimin e zyrtarëve nga vetë ARH-ja

Keshtu që te gjitha punët dhe shërbimet nga sektori I Financave ne bashkepunim te plotë me zyrtaret e MTPT-së kanë rrjedhur sipas afateve kohore zyrtare dhe sipas dinamikës së planifikuar

Ne fillimisht do të jepim një pasqyrë financiare të te të gjitha Kategorive buxhetore deri më 30.11.201

Kategoria

Paga dhe Meditje;rrjedhshmeria dhe paraqitja e listë-pagave,formulareve per punetor te rinj,rektroaktivet ,formuletet per ndryshime janë paraqitur qdohere sipas afateve kohore te percaktuara me ligj

Mallra dhe Sherbime: rrjedhshmeria e shpenzimeve ka qenë sipas planifikime dhe afateve ligjore te percaktuara me ligj dhe te gjitha procedurat per pagesa janë zhvilluar sipas rregullave dhe kriterëve te lejuara


Shpenzime Komunale:pasi qe ne si institucion kemi filluar se funksionuari ne lokacion te ri ne periudhen e fundit te fundvitit nga kjo kategori kemi pak shpenzime te bëra për arsye tashmë te lartëpermendura

Subvencione;Nuk kemi patur subvencione gjatë ketij viti as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonje nivel tjetër

Shpenzime kapitale: Nuk kemi patur shpenzime kjo kategori fare edhe pse nevojat per shpenzime nga kjo kategori janë te domosdoshme pikerisht shpenzime per blerje te Veturave per nevojat te institucionit mirëpo mbetet obligim I periudhes së ardhshme

RAPORTI VJETOR I ARH-së 2010

Nr	Kategoritë e shpenzimeve	Të aprovuara	Të shpenzuara	Të zotuar
1	Paga dhe Mëditje	58,092.00	27,596.00	-
2	Mallra dhe Shërbime	98,773.00	19,221.70	79,450.19
3	Shpenzimet Komunale	14,000.00	-	2,600.00
4	Subvencionet	-	-	-
5	Shpenzimet Kapitale	-	-	-
	Raporti përmbledhës	170,865.00	46,817.70	82,050.19



Paraqitja

grafike

Synimi	Detyrat e planifikuara: Zyrtari për Financa -Shkelzen Qorri	Realizimi	Autoriteti përgjegjës	Përkrahur nga	Afati kohor	Rekomand
Ngritja e nivelit të shërbimit	<p>Në kordinim me menaxhmentin Menaxhon me buxhet dhe financa në kuadër të ARH-së;</p> <ul style="list-style-type: none"> Koordinon me të gjithë faktorët relevantë, që janë të kyçur në ndonjë formë në sferën e buxhetit dhe financave në kuadër të ARH-së dhe subjekteve relevante; Është përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë sferën e buxhetit dhe financave; 	<p>- Kemi menaxhuar me buxhetin e ARH-së</p> <p>- Kemi bashkëpunuar me të gjithë faktorët relevante që kanë të bëjnë me sferën e buxhetit dhe financave si në ARH ashtu edhe me MTPT(sipas marrëveshjes së bashkëpunimit) dhe MEF</p> <p>- Janë zbatuar ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë buxhetin dhe Financat publike</p>	<p>Drejtori i përgjithshëm dhe KD/Departamentit të Administratës</p>	<p>Drejtori i përgjithshëm dhe KD/Departamentit të Administratës</p>	<p>Tetor-Nentor 2010</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrollon dhe raporton shpenzimet e ARH-së sipas akteve mbi financat publike; • Mirëmban gjendjen e shpenzimeve buxhetore, duke i krahasuar dhe barazuar raportet e ARH-së dhe MEF-it; • Përcjellja e zotimeve për ARH-në sipas gjendjes së paraqitur nga Thesari • Organizon punët e Sektorit të financave 	<p>- Është bere kontrollimi i shpenzimeve dhe është bere sistemimi i tyre</p> <p>- Përcillet gjendja e shpenzimeve që janë 46817.70 ne çdo moment me raportin e Thesarit</p> <p>Përgatitja e lëndëve për zotim dhe zotimi i tyre : Gjithsej gjatë periudhës raportuese janë bërë 82050.19€ ne vlerë /zotime ,ndersa te analuar kemi një zotim per inventar 13000€vlerë</p> <p>Kompletimi I lendeve per procedime te mëtejme dhe</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Tetor-Nentor 2010</p>
--	---	---	--	--	--------------------------

		kryerja e pagesave				
	<ul style="list-style-type: none"> • Përkujdeset për paranë e gatshme sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi në lëmin e financave; • Mbyllje të avanseve; • Përkujdesja e zyrtarizimit të mbajteseve të llogarisë për ARH-në • Mbajtja e kontakteve me Zyren e Auditorit Gjeneral 	<p>Është hapur një Petty Cash(ende I pa terhequr ne vlerë prej 1.000.00€)</p> <p>Tërheqja dhe mbyllja e dy avanseve ne vlerë prej 4120.00€ dhe 824.00€ sipas kerkesave te aprovuara per udhetime zyrtare për Francë.</p> <p>Kthimi i mjeteve në bankë dhe mbyllja e avancit per Francë</p> <p>Zyrtarizimi I dy zyrtarëve si mbajtes se llogarisë se avanseve(Shkelzeni dhe Mirjeta)</p> <p>Finalizimi I pytesorit të verifikimit rrenjesor te menaxhimit financiar nga</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe</p> <p>KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe</p> <p>KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Tetor-Nentor 2010</p>	

	<ul style="list-style-type: none"> Kryen çdo detyrë tjetër që kërkohet nga eprori përkatës. 	<p>ZAGJ</p> <p>Finalizimi I shumë punë tjera jashtë sektorit të Financave sipas kerkesës së Drejtorit</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Drejtori i pergjithshem dhe KD/Departamentit të Administrates</p>	<p>Tetor-Nentor 2010</p>
--	--	---	--	--	--------------------------

Prokurimi:

Raporti i Prokurimit nga 01.01.2010-31.12.2010						
Nr.	Njësia e kërkeses	Datë	Përshkrimi	Zotimi i buxhetit		Nr. i Prokurimit
				FPP	Shuma ne €	
1			Furnizim me Inventar		9,900.00 €	314 01 10 136
2			Web faqja e ARH-së		1,500.00 €	314 02 10 236
3			Punimi I Logos		200.00 €	314 003 10 247
4			Material Shpenzes per zyre		2,000.00 €	314 10 004 136
5			Instalimi I Centrales telefonike		2,000.00	314 10 005 236
6			Furnizim me frigorifer (ne procedurë)		400	314 10 006 147
7			Sherbime te Pastrimit		njevjeçare	314 10 007 236
8			Sigurimi Fizik I objektit (ne procedurë)		njevjeçare	314 10 008 236
9			Shenjat orientuese (ne procedurë)		njevjeçare	314 10 009 147
10			Flat Monitor (ne procedurë)		800	314 10 10 147

Kjo tabele rifreskohet pas kryerjeve te gjitha sherbimeve të Prokurimit për vitin 2010.